



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:114938

Datë: 22.01.2025

Numri i dokumentit: 06743302

P.nr.83/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E G nga fshati D K.K, për shkak të veprave penale, Ndertimi pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së, dhe Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.252/2024 të datës 15.05.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt.17.12.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala dhe i pandehuri E G dhe mbrojtësi i tij av.Prenk Palushi, me dt.17.12.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.01.2025, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E G nga i ati V e ëma M e gjinisë P, i lindur me datë në P, tani me banim në fshatin D K.K, me nr.personal:, ka të kryer shkollën e mesme, martuar, baba i femijve, me profesion g, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më parë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

- I. SEPSE nga data 29.02.2024 e në vazhdimësi gjerë me datën 28.03.2024 në rrugën „Q A,, në fshatin D K.K, si pronar dhe investitor ndërton objekt pa leje për të cilën kërkohet leja e tillë në bazë të ligjit për ndërtim dhe atë nenit 7 dhe 14, në atë mënyrë që i pandehuri në vendin e lartcekur në pronën e babit të tij, në ngastrën kadastrale P-71010027-00310-0 kishte filluar ndërtimin e një shtëpie me material të fortë një katëshe

për të cilën nuk kishte leje ndërtimore me datën 29.02.2024 Komuna e K-D e I i kishin vendosur shiritat duke i ndërprerë punimet kundër kësaj i njëjti vazhdon të ndërtoj objektin.

Me çka ka kryer vepër penale „Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.2 të KPRK-së.

- II. Më parë e gjer datën 03.03.2024 në rrugën „Q A në fshatin D K.K, ka hequr shenjën zyrtare të vendosur nga Inspektorët e ndërtimit, në atë mënyrë që i pandehuri si investitor në pronën e babit të tij në ngastrën kadastrale P-71010027-00310-0 fillon ndërtimin e shtëpis së tij si në dispozitivin I, ku me të vërejtur nga ana e inspektorve komunal sipas procesverbalit të dt.29.02.2024 i janë ndërprerë punimet dhe vendosur shiritat por ai përkundër kësaj, i heq shiritat dhe vazhdon punimet më pas nga inspektorët e lartcekur ku është pëpiluar procesverbali me dt.03.03.2024.

me çka ka kryer vepër penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69,70 dhe nenit 359 par.2 dhe neni 406 par.1 dhe 367 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPRK-së:

GJYKON

Të pandehurit E G

I.Sipas dispozitivit -1- i përcakton dënim me Burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit dënimi me burg i zëvendësohet me dënim me gjobë shuma në vlerë prej tetëqind (800) €,

II.Sipas dispozitivit -II- i përcakton dënim me gjobë shuma në vlerë prej dyqind (200) €.

Pas Unifikimit të dënimeve në kuptim të nenit 76 par.1 dhe 2, pika 2.2 të KPRK-së,

I.Gjykata të pandehurin E G e dënon me Dënim Unik me Gjobë shuma në vlerë prej njëmijë (1000) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej (tridhjetë) 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë nga një (1) ditë burgim.

II.DETYROHET: i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzetë) Euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III.UDHËZOHET: Pala e dëmtuar Komuna e Klinës, drejtoria për kadastër-njësi i inspektorëve për realizimin e kërkesës pasurore juridike, ta realizojë në kontest të rregullt civil.

IV.Në kuptim të nenit 359 par. 5 të KPRK-së, ndërtimi pa leje të rrënohet dhe shpenzimet ti bartë kryesit.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.525/2024 e datës 30.04.2024, kundër të pandehurit E G nga fshati D K.K, për shkak të veprave penale, Ndërtim pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale; Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 i KPRK-së.

Gjykata me datë 17.12.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i pandehuri E G dhe mbrojtësi i tij av.Preng Palushi.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.17.12.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën , të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri E G pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij av.Preng Palushi, ka deklaruar se e pranon fajësinë për

veprën penale që i vihej në barrë, më vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprat penale të kryera, po ashtu deklaroi se unë nuk e kam ditur se nuk e kisha bërë ndërtimin e shtëpisë pa leje por jam bazuar në atë se të gjithë fqinjët më kanë thënë se nuk ka nevojë për leje dhe unë e kam ndërtuar pasi që unë jetoj në Zvicerr nuk kam pasur njohuri të plotë.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Prenk Palushi, ka propozuar që gjykata ta miratojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri me qëllim të plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 242 të KPRK-së. Me rastin e individualizimit dhe matjes së dënimit, kërkoj nga gjykata që të ketë në konsiderat rrethanat lehtësuese të përcaktuara me dispozitën e nenit 70 të KPRK-së siq janë, pranimi i fajësisë, pendimi për veprën penale të kryer nga i pandehuri, premtimi që në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale, sjellja e kryesit para dhe pas kryerjes së veprave penale, fakti që është hera e parë që i pandehuri bie ndesh me ligjin, mosha e tij ere, si dhe bashkëpunimi i të pandehurit me gjykatën , ku dihet se me vet faktin se i njëjti jeton në Zvicerr merr pjesë në këtë seancë si dhe në seancën e Prokuroris me rastin e dhënjes së deklaratës në procedurë paraprake. Ashtu që i propozoj Gjykatës që brenda suazave ligjore të pandehurit për veprën „heqja apo dëmtimi i shenjave zyrtare,, të i shqiptoj dënim me gjobë me qëllim për këtë veprë parashihet dënim alternativ ndërsa për veprën e dytë penale , ndërtim pa leje , dënim kumulativ të i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje deri në 6 muaj në suazat e minimumit ligjor të paraparë ashtu që i njëjti ti zëvendësohet me dënim me gjobë me pëlqimin e të pandehurit në kuptim të nenit 44 të KPRK-së. Kujtoj dhe jam thellësisht i bindur që me dënimet e propozuara arrihet qëllimi i dënimit, mbrojtja penale juridike , preventiva gjenerale dhe speciale si dhe lloji dhe lartësia e dënimit është adekuate me llojin dhe peshën e veprave penale. Propozoj gjykatës që në bazë të nenit 79 të KPRK-së, dënimin e paguar për kundërvajtje i pandehuri vlera në shumë prej 2000 euro ta përfshij në dënimin potencial me gjobë për të pandehurin.

Deklarimi i palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij , pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPRK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm,

i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të merr parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale, të cilat mbështesin aktakuzën, si : Shënim zyrtar i policit R G i dt.03.03.2024, Raporti fillestar i incidentit i dt.03.03.2024, Raporti i oficerit manush morina i dt.03.03.2024, Raporti i oficerit E B i dt.28.03.2024, Deklarata e të pandehurit E G e dhënë në Stacionin Policor në Klinë, me dt.06.03.2024, Kërkesë për kushtet ndërtimore i dt.04.03.2024, Çertifikata –njësia kadastrale P-71010027-00310-0 në emër të V G e dhënë në Stacionin Policor në Klinë me dt.03.03.2024, Procesverbal nga Komuna e Klinës mbi kryerjen e kontrollit inspektues të dt.29.02.2024, Procesverbal nga Komuna e Klinës mbi kryerjen e kontrollit inspektues të dt.03.03.2024, Deklarata e të pandehurit J B e dhënë në këtë Prokurori e dt.05.04.2024, deklarata e të pandehurit E G e dhënë në këtë Prokurori me dt.29.04.2024, foto nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera në lëndë.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Bazuar në të lartëcekurat gjyqtari i vetëm gjykuese ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale, Ndërtim pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në nenin 359 par.2 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen,, Personi i cili është pronar, investitor apo person përgjegjës i subjektit juridik i

cili është investitor në objektin në ndërtim pa leje ndërtimi, kur me ligj kërkohet leje e tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në (pesë) 5 vite, dhe në nenin 406 par.1 të KPRK-së formën themelore të veprës e kryen,, kushdo që heq apo të dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose të lokaleve, apo kushdo që hap objektet e siguruara ose hyn në lokalet e tilla pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën apo shenjën ose hap sendin në të cilën ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet ,,.

Andaj bazuar në të lartëcekura, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale,, Ndërtim pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale ,,Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 të KPRK-së, nga se veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke e vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, padënueshmërinë e tij më parë, , moshën e re të pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësis penale.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerje e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par.2.6 të KPPK-së.

Vendimi për taksen për kompensimin e viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 par.1 pika 1.5 dhe nenin 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-36 për Kompensimin e viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.83/2024 me datë 22.01.2025

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Bashkëpunëtorja profesionale
Fatmire Elezaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.